



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR, "PARTIA DEMOKRATE PËR INTEGRIM E**  
**PROSPERITET" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS**  
**30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.03.2019, me pjesëmarrjen e:

|         |           |            |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI -   | Kryetar    |
| Denar   | BIBA -    | Zv/Kryetar |
| Bledar  | SKËNDERI- | Anëtar     |
| Edlira  | JORGAQI-  | Anëtare    |
| Rezarta | BITRI-    | Anëtare    |

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, "Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 64, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datës 05.11.2018 ka caktuar datën 30 qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet, me shkronja nistore "P.D.I.P", nëpërmjet Kryetarit të saj, z.Kujtim Muça, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019, administruar me nr.1496 prot., datë 18.03.2019.

Kërkesa e paraqitur nga "Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet", respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

**Nr.107 i Vendimit      Data 27.03.2019      Ora 12:00 e Vendimit**

Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, "Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet ", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019



Nga analiza e dokumentacionit paraqitur bashkëlidhur kërkesës, evidentohet respektimi në mënyrë të plotë, në formë dhe përmbajtje, i kërkesave të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Konkretisht është paraqitur:

- Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 18.03.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet se "Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet", me initiale "P.D.I.P", dhe me Kryetar z.Kujtim Muça, rezultoi e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- specimeni i vulës së partisë;
- emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (z.Shkëlqim Muça);
- emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z.Kujtim Muça);

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas verifikimeve përkatëse dhe konstatimit se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga "Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet", janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

#### **V E N D O S I:**

1. Të regjistrojë "Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet", me kryetar z.Kujtim Muça, dhe shkronja nistore "P.D.I.P", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Klement ZGURI - Kryetar**

**Denar BIBA- Zv/Kryetar**

**Bledar SKËNDERI- Anëtar**

**Edlira JORGAQI - Anëtare**

**Rezarta BITRI- Anëtare**

**Nr.107 i Vendimit      Data 27.03.2019      Ora 12:00 e Vendimit**

Për regjistrimin si subjekt zgjedhor, "Partia Demokratike për Integrim e Prosperitet", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

